



Republika e Kosovës



Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Përsoneel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 34

Datë: 26.04. 2022.

KONTRATË PROKURIMI NR 17

62500-22-1532-2-3-6/C479

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

“ Radio Kosova e Lirë ” me seli në Prishtinë me nr.biznesi 810478405 (në vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli: PUBLIKIMI I AKTIVITETEVE PUBLIKE , NJOFTIMEVE NË WEB DHE RADIO

Nr. i Prokurimit ¹	62500-22-1532-2-3-6
Nr i brendshëm	62500/22/011/236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve :

PUBLIKIMI I AKTIVITETEVE PUBLIKE , NJOFTIMEVE NË WEB DHE RADIO

No.	Lot
1.	PUBLIKIMI I AKTIVITETEVE PUBLIKE , NJOFTIMEVE NË WEB DHE RADIO

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë : 4,992.00€ [katërmijëenëntëqindëenëntëdhjetëedyeuro]. Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Ahmet Qeriqi
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	26.09.2022
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-22-1532-2-3-6/C479

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : 26.04.2022.
	6.2	Data e Përfundimit është : 26.04.2024.
	6.3	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : Komuna Malishevë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i kontratës është : z.lzet Shala shef. për informim i caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjes për mbikqyrjen e ofruesit të shërbimeve të OE për tërë periudhën sa zgjatë kontrata duke filluar nga dita e parë e fillimit të shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Qellimi i mbikqyrjes është të kontrolloj kryerjen e shërbimeve nga OE.
Obligimet e OE	12.4	OE është i obliguar gjatë realizimit të kontratës ti realizoj detyrat e përcaktuar tek specifikacionit i detyrueshëm i Aneks 2. i DT. - Se paku ne dy emisione kryesore informative operatori ekonomik do te lexon ne tërësi kumëtesat dhe lajmet te cilat i dërgohen nga zyra e Informimit të Komunës së Malishevës. - Do të afishohet logoja e Komunës se Malishevës me dimensionet 300 x 250 px dhe ajo ne rast nevojë do te rifreskohet ; - Publikimi i urimeve dhe festave shtetërore , Epopeja e UÇK-së 5 , 6 dhe 7 Mars, Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës; - Publikimi i Komunikatave dhe intervistave sipas kërkesës se Komunës se Malishevës në radio dhe web faqe; - Publikimi i komunikatave, njoftimeve dhe publikimeve tjera ne

		media elektronike Radio dhe web faqe. - OE është i obliguar që publikimin sipas pikave të lartëshenuar ti publikojë në radio dhe webfaqen e vet.
Pagesat	13.1	Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin për pranim të publikimit të aktiviteteve publike, njoftimeve në web dhe radio nga zyrtari i caktuar nga ZKA dhe faturën nga OE të ia paguaj shumën sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate. AK e ruan të drejtën që ta e ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe nese nuk iu përmbahet plotësisht kushteve të kontratës.
Dëmet e likuiduara	13.2	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: EUR.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>[shëno shumën]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë : për muaj sipas raportit të menaxherit të kontratës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[shëno]</i> Periudha Garantuese e Defekteve është <i>[shëno datën]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndermjetesim pranë Ministris së Drejtësis.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykata Themelore Prishtinë)</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

PUBLIKIMI I KOMUNIKATAVE, NJOFTIMEVE NË WEB DHE RADIO

PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr.rend	Emri i projektit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.	Publikimi i aktiviteteve publike, njoftimeve në web dhe radio	Muaj	24	208.00 €	4.992.00 €
TOTALI:					4.992.00 €